



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0368

Data e Vendimit: 31.07.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 21.07.2023 për tërheqje nga ankesa e parashtruar nga OE “SBP CONSTRUCTION SH.P.K.”- Prishtinë, e parashtruar me datë: 08.06.2023 me nr. 2023/0368 lidhur me aktivitetin e prokurimit “asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit - Lot 1 deri ne Lot 4” me nr. të prokurimit: 651-23-1153-5-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e autoriteti kontraktues, Vjosa Gradinaj, Agon Ramadani dhe Vedat Poterqoi me datën: 31.07.2023, mori këtë:

Vendim

Aprovohet, kërkesa e “SBP CONSTRUCTION SH.P.K.”- Prishtinë, e datës 21/07/2023 e parashtruar për tërheqjen e ankesës së datës 08/06/2023 (Protokolli 2023/0368) dhe i lejohe Kuvendi Komunal Gjilan Autoriteti që nga cilësia e autoritetit kontraktues të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit - Lot 1 deri ne Lot 4” me nr. të prokurimit: "651-23-1153-5-1-1, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa pas pranimit të raport të ekspertit shqyrtues, duke u bazuar në nenin 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE, në emër të shpenzimeve procedurale i konfiskohet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 08/06/2023, Operatori ekonomik "SBP CONSTRUCTION SH.P.K."- Prishtinë, ka paraqitur ankesë në OSHP (Protokolli 2023/0368), lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit - Lot 1 deri ne Lot 4" me nr. të prokurimit: "651-23-1153-5-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK).

Me 21/07/2023 Operatori ekonomik "SBP CONSTRUCTION SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës (e precizuar me datë dhe evidencë si më sipër) nga sistemi elektronik i prokurimit *e-prokurimi*, e cila është vërtetuar sipas detyrës zyrtare të OSHP.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si më sipër, Bordi mori vendim për aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesa duke i lejuar AK që ta vazhdojë aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si më sipër) nëse AK nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet. Krahas kësaj po ashtu duhet theksuar se në të tilla raste mungon efekti pezullues i ankesës në kuptim të nenit 112, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit dorëzimi i një ankese e obligon AK që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret. Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore në këtë fazë, pa nevojë që të hapet faza e vlerësimit merititor lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore para OSHP në këtë fazë dhe lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se:

- Mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;
- Ankuesit, i mungon statusi i palës së interesuar, sipas nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se në kuptim të nenit 13, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kurse në kuptim të nenit 109, paragrafi 1, të LPP, po ashtu parashihet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Mirëpo, në kuptim të parimeve bazë të legjislacionit, posaçërisht parashikuar me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, kjo njëherësh nënkupton faktin se çdo do palë e interesuar ka të drejtë po ashtu ta ndryshoj (plotësoj, përmirësoj, precizoj) ankesën dhe po ashtu ta tërheq atë.

Në fakt, OSHP ka konfirmuar faktin e tërheqjes së ankesës, bazuar në veprimet e palës përmes publikimit të tyre në platformë, përkatësisht faqen zyrtare të sistemit të prokurimit publik por nga

ana tjetër nuk gjeti arsye për të vepruar në kuptim të nenit 110 të LPP andaj janë krijuar kushtet që procedura në këtë çështje juridiko administrative të përfundoj në kuptim të nenit 97 të LPPA.

OSHP gjithnjë nisat nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kriereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen *vetëm në kriteret e nevojshme* për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues *nuk duhet* që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Bordi i OSHP-së i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa pas pranimit të raport të ekspertit shqyrtues, duke u bazuar në nenin 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE, në emër të shpenzimeve procedurale i konfiskohet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Kryetarja e OSHP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e OSHP

Vjosa Gradinaj – Mexhuani

Agon Ramdani-Anëtar Bordi

Vedat Poterqoi –Anëtar Bordi



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK – KUVENDI KOMUNL GJILAN
- OE - SBP CONSTRUCTION SH.P.K."- Prishtinë